




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Komuna e Gjakovës merr këtë:



Nr.01-VA/2024

Datë: 10/ 02 /2024

V E N D I M

Aprovohet kërkesa për qasje në dokumente publike nga znj. Rudina Hasimja, përfaqësuese e Organizatës “Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur – KCSF” duke i ofruar qasje të plotë në dosjen e subvencionimit të OJQ-ve nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Arsyetim

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Komuna e Gjakovës, ka pranuar një kërkesë nga znj. Rudina Hasimja, përfaqësuese e Organizatës “Fondacioni Kosovar për Shoqëri të hapur – KCSF”, për qasje në dokumente publike, përkatësisht qasje të plotë në dosjen e subvencionimit të OJQ-ve nga drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Pas pranimit të kërkesës, ZQDP ka shikuar për gjetjen e këtyre dokumenteve dhe pas gjetjes, të njëjtat i dorëzohen palës kërkuese.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, përmes zyrtarit për QDP të Komunës së Gjakovës, mund të paraqesë ankesë në Shtyllën për Qasje në Dokumente Publike të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kërkuessit: Rudina Hasimja - KCSF
- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Zyrtarit për QDP – z. Artan Haraqia
- Arkivit të Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës